



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 paragraf 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (e), të Ligjit Nr. 03L/040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin, 5, 6 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017, për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 04.03.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Ismet Çekaj** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Deçan, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Uran Tolaj.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Ismet Çekaj dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ, më datën 22.02.2021, Nr. 782/2021, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Uran Tolaj, për arsye se i njëjti ka munguar në seancat e Kuvendit Komunal.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rirenditur është, z.Ismet Çekaj, i cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I, të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.03.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

